



Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit

Programi:	Master i Edukimit STEAM
Kursi:	Metodat e hulumtimit në arsim
Statusi i kursit	Obligativ
Ligjëruesi/t Profesor: Asistent:	Prof. asoc. Fatlume Berisha Ass. Fortina Kastrati
Kontaktet (e-mail):	fatlume.berisha@uni-pr.edu fortina.kastrati1@student.uni-pr.edu
Koha / lokacioni:	E hënë, 17:45-19:15, Online (L) E enjte, 18:30 – 20:00, salla 105 U
Linku/qet:¹	https://classroom.google.com/c/ODAzMzgZMzcxOTkx?cjc=y2i7bx5h Google Classroom CODE: y2i7bx5h

I. Përshkrimi

Ky kurs prezanton studentët me paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimit në arsim, duke kombinuar qasjen teorike me praktikën e realizimit të një projekti hulumtues. Studentët mësojnë të dallojnë llojet kryesore të hulumtimeve sasiore, cilësore dhe të përziera, të zhvillojnë aftësi për lexim dhe analizë kritike të literaturës, si dhe të aplikojnë instrumente dhe metoda për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Kursi synon t'i pajisë studentët me kompetencat e nevojshme për të dizajnuar dhe implementuar një projekt hulumtues në fushën e edukimit, duke reflektuar gjithashtu mbi parimet etike dhe filozofike që udhëheqin kërkimin shkencor.

II. Rezultatet e pritura

Rezultatet e pritura të ndara sipas dimensionit të njohurive, shkathtësive dhe vlerave.

Dimensioni i njohurive

Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- shqyrtojnë konceptet bazë dhe metodat e hulumtimit në edukim dhe shkencat sociale;
- identifikojnë problemet kryesore të lidhura me procesin e mësimdhënies dhe të nxëniet që mund të jenë objekt i hulumtimit;
- përshkruajnë fushat më të rëndësishme të hulumtimit në edukim që kontribuojnë në avancimin e praktikave mësimore;

¹ Google classroom platforma online

- kuptojnë llojet kryesore të hulumtimeve sasiore dhe cilësore;
- shpjegojnë aspektet kryesore etike dhe metodologjike të realizimit të një projekti hulumtues (validiteti, besueshmëria, përgjithësimi).

Dimensioni i shkathtësive

Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- analizojnë hulumtimet ekzistuese në fushën e edukimit përmes shqyrtimit të literaturës, metodave dhe rezultateve;
- planifikojnë dhe dizajnojnë hapat e një hulumtimi edukativ;
- hartojnë pyetje kërkimore, hipoteza dhe objektiva hulumtues të qarta;
- zhvillojnë dhe përdorin instrumente të ndryshme për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore;
- analizojnë, interpretojnë dhe raportojnë të dhënat nga hulumtimet sasiore dhe cilësore;
- zhvillojnë një projekt hulumtues të plotë që përfshin planifikimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe interpretimin e rezultateve.

Dimensioni i vlerave dhe qëndrimeve

Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- tregojnë ndershmëri akademike dhe respektim të standardeve etike gjatë procesit të hulumtimit;
- zhvillojnë një qasje kritike dhe reflektuese ndaj literaturës shkencore dhe rezultateve empirike;
- vlerësojnë rëndësinë e hulumtimit për zhvillimin profesional dhe përmirësimin e praktikave arsimore;
- nxisin bashkëpunimin dhe respektin për diversitetin në hulumtime;
- kultivojnë qëndrime të përgjegjshme për përdorimin e të dhënave dhe raportimin e rezultateve.

III. Metodologjia e mësimdhënies

Metodologjia e mësimdhënies që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt involvimit aktiv të studentëve. Kursi është i organizuar në 2 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime javore.

- Ligjëratat do të përdoren për prezantimin e koncepteve teorike, qartësimin e metodave të hulumtimit dhe ndërlidhjen e tyre me praktikën arsimore. Këto prezantime do të shërbejnë si pikënisje dhe formulim i kornizës brenda së cilës do të orientohet puna e studentëve.
- Ushtrimet do të fokusohen në zbatimin praktik të njohurive përmes analizës së rasteve konkrete, shqyrtimit të literaturës, punës në grupe, si dhe prezantimeve të studentëve. Në këtë mënyrë, studentët do të ushtrojnë aftësitë e tyre kërkimore, hulumtuese duke reflektuar dhe duke shkëmbyer përvoja.
- Detyrat praktike do të zhvillohen në përputhje me temat javore, duke përfshirë hartimin e pyetjeve kërkimore, zhvillimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, si dhe analizën dhe interpretimin e rezultateve.
- Mësimi i orientuar drejt projektit (project-based learning) do të inkurajohet përmes zhvillimit të një projekti hulumtues në grup, ku studentët do të kalojnë të gjitha fazat e procesit kërkimor.
- Reflektimi dhe etika do të theksohen në çdo hap, për të nxitur tek studentët ndershmërinë akademike, mendimin kritik dhe qasjen profesionale ndaj hulumtimit.

IV. Plani i detajuar i kursit

Java	Tema	Literatura	Qëllimi/Aktiviteti/Detyrat
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i kursit, Paraqitja e syllabusit dhe detyrave,	Syllabusi	Qëllimi: Studentët të njihen me strukturën, objektivat, detyrat dhe mënyrën e vlerësimit të kursit.
			Aktiviteti: Diskutim i hapur për pritjet e tyre; prezantimi i syllabusit; prezantimi i metodologjisë së punës. Ushtrime (e enjte): Pritjet e studentëve dhe formimi i grupeve
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në metodologji të hulumtimit Hulumtimet në edukim, konceptet bazë, etika në hulumtim	[1] Mattheus & Ross, Pjesa A, fq. 6–86	Qëllimi: Studentët të shpjegojnë konceptin e hulumtimit në edukim dhe të reflektojnë mbi etikën.
			Aktiviteti: Ligjëratë hyrëse; punë në grupe mbi perceptimet për hulumtimin; Ushtrime (e enjte): Analiza e një rasti etik në hulumtim Reflektimi 1 (individual). <i>SHIH UDHËZIMET PËR REFLEKTIMET</i>
<i>Java tretë:</i>	Elemente themelore të procesit të hulumtimit Planifikimi i hulumtimit, formulimi i problemit, pyetjeve dhe hipotezave	[1] Mattheus & Ross, Pjesa A4, faqe 56-69. [1] Pjesa B4-B6, faqe 140 - 178	Qëllimi: Studentët të aftësohen të formulojnë një problem hulumtues dhe pyetje kërkimore.
			Aktiviteti: Ushtrime praktike mbi formulimin e pyetjeve; Ushtrime (e enjte): Ushtrime mbi formulimin e pyetjeve kërkimore. Shtesë: Worksheet me shembuj të problemeve hulumtuese dhe pyetjeve të paqarta për t'i riformeluar. Worksheet me shembuj pyetjesh të dobëta dhe të forta për diskutim. Reflektimi 2 (individual). Detyra 0 (grupore): Jepni një titull të shkurtër dhe kuptimplotë për projekt propozimin tuaj <i>SHIH UDHËZIMET PËR DETYRAT MË POSHTË</i>
<i>Java katërt:</i>	Shqyrtimi i literaturës Rëndësia dhe teknikat e shqyrtimit të literaturës	[1] Pjesa B2, faqe 92-109	Qëllimi: Studentët të aftësohen të identifikojnë dhe sintetizojnë literaturën relevante.
			Aktiviteti: Demonstrim i databazave; Ushtrime (e enjte): Analiza e një artikulli + përmbledhje në grupe; Shtesë: Artikull shkencor + worksheet me pyetje udhëzuese për analizë literature. Reflektimi 3 (individual); Detyra 1 (grupore): Draftimi i idesë së projektit

			hulumtues
Java pesë:	Llojet e hulumtimeve Hulumtime cilësore, sasiore dhe të përziera; dizajni i hulumtimit	[1] Pjesa B3, faqe 110-139	<p>Qëllimi: Studentët të dallojnë llojet e hulumtimeve dhe të zgjedhin dizajnin adekuat.</p> <p>Aktiviteti: Ligjëratë + shembuj praktikë;</p> <p>Ushtrime (e enjte): Krahasimi i dizajneve në shembuj konkretë; Shtesë: Worksheet me studime rasti ku studentët identifikojnë dizajnin e përdorur.</p> <p>Reflektimi 4 (individual).</p>
Java gjashtë:	Mbledhja e të dhënave sasiore Metodat e mbledhjes së të dhënave sasiore	[1] Mattheus & Ross, Pjesa C, fq. 179–246 (pjesët për sondazhe, pyetësorë, testime)	<p>Qëllimi: Studentët të aftësohen të hartojnë dhe të përdorin instrumente për mbledhjen e të dhënave sasiore.</p> <p>Aktiviteti: Ligjëratë mbi formatet e pyetësorëve dhe matjen e variablave.</p> <p>Ushtrime (e enjte): Hartim dhe pilotim i një pyetësori të shkurtër; Analizë e një instrumenti ekzistues sasiore (p.sh. një pyetësor nga literaturë).</p> <p>Reflektimi 5 (individual)</p> <p>Detyra 2 (grupore): Hyrja dhe rëndësia e projektit hulumtues</p>
Java shtatë:	Mbledhja e të dhënave cilësore Metodat e mbledhjes së të dhënave cilësore	[1] Mattheus & Ross, Pjesa C4, fq. 219–233 (intervistat, vëzhgimi, grupet fokale, dokumentet)	<p>Qëllimi: Studentët të hartojnë instrumente cilësore (intervista, udhëzues për fokus-grupe, etj.) dhe të kuptojnë përdorimin e tyre.</p> <p>Aktiviteti: Ligjëratë mbi metodat cilësore.</p> <p>Ushtrime (e enjte): Simulim i intervistave / fokus-grupeve; Shtesë: Artikull i shkurtër open-access për përdorimin e intervistës si metodë hulumtuese në edukim. Përgatitja e një udhëzuesi për intervistë ose fokus-grup.</p> <p>Reflektimi 6 (individual)</p>
Java tetë:	TESTI 1 Vlerësim i njohurive të fituara (Java 1–7)		<p>Qëllimi: Studentët të demonstrojnë njohuritë mbi konceptet bazë dhe metodat e hulumtimit.</p> <p>Aktiviteti: Testi 1.</p> <p>Ushtrime (e enjte): Workshop reflektiv: diskutim mbi llojet e pyetjeve dhe çfarë kemi mësuar nga testi; hyrje praktike për temën e radhës (analiza e të dhënave).</p> <p>Detyra 3 (grupore): Shqyrtimi i literaturës</p>
Java nëntë:	Analiza e të dhënave sasiore	[1] Mattheus & Ross, Pjesa D1–D5, fq. 315–370	<p>Qëllimi: Studentët të përdorin teknika bazike statistikore për analizimin e të dhënave sasiore.</p> <p>Aktiviteti: Ligjëratë mbi përshkrimin dhe interpretimin e të dhënave numerike.</p> <p>Ushtrime (e enjte): Ushtrime me dataset të thjeshtë në Excel; Ushtrime me tabela të dhënash për llogaritjen e mesatares, devijimit standard, korrelacionit të thjeshtë. Shtesë: Worksheet me të dhëna të thjeshta për analiza statistikore bazike. Interpretimi i një seti të dhënash sasiore.</p>

			Reflektimi 7 (individual): Detyra 4 (grupore): Pyetjet, hipotezat dhe dizajni i studimit
Java dhjetë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore	[1] Mattheus & Ross, Pjesa D4–D9, fq. 371–423	Qëllimi: Studentët të përdorin metoda të analizës cilësore si kodimi, tematizimi dhe interpretimi i narrativës. Aktiviteti: Ligjëratë mbi teknikat e analizës cilësore. Ushtrime (e enjte): Kodimi i një transkripti të shkurtër në grupe. Ushtrime praktike: kodim i një fragmenti intervistash ose fokus-grupi. Shtesë: Artikull i shkurtër ose studim rasti mbi analizën tematike në edukim. Analiza e një pjese të dhënash cilësore (p.sh. intervistë e shkurtër). Reflektimi 8 (individual):
Java njëmbëdhjetë:	Te analizojmë analiza sasiore përmes EXCEL Nxjerrja e përfundimeve	[1] Pjesa D10, Faqe 424 - 426	Qëllimi: Studentët të përdorin mjete bazike statistikore dhe të nxjerrin përfundime nga të dhënat. Aktiviteti: Worksheet me tabela Excel për analizë. Ushtrime (e enjte): Workshop mbi shkrimin e përfundimeve të mbështetura në të dhëna Reflektimi 9 (individual). Detyra 5 (grupore): Instrumentet dhe mbledhja e të dhënave
Java e dymbëdhjetë :	Hulumtimet kuantitative dhe kualitative, përsëritje Përmbledhje e hulumtimeve kuantitative dhe kualitative		Qëllimi: Studentët të sintetizojnë dhe krahasojnë qasjet kërkimore. Aktiviteti: Diskutim integruar; Ushtrime (e enjte): Grupet sjellin literaturë shtesë për projektin dhe justifikojnë zgjedhjen e tyre. Shtesë: Pyetje krahasuese (cilësore vs. sasiore).
Java e trembëdhjetë:	Paraqitja e të dhënave dhe raportet Si të prezantojmë një punim hulumtues?	[1] Pjesa E1-E3, faqe 429 - 471	Qëllimi: Studentët të përgatisin një raport hulumtues dhe të prezantojnë të dhënat qartë. Aktiviteti: Demonstrim i prezantimit shkencor; Ushtrime (e enjte): Ushtrime për krijimin e grafikëve, tabelave dhe prezantimit vizual të të dhënave Shtesë: Rubrikë për vlerësimin e prezantimit shkencor. Reflektimi 10 (individual). Detyra 6 (grupore): Analiza dhe interpretimi i të dhënave
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i raporteve përfundimtare Metodologjia e kërkimit dhe plani i projektit	[1] Mattheus & Ross, Pjesa E, fq. 429–450	Qëllimi: Studentët të prezantojnë draftin e metodologjisë dhe planin logjik të projektit. Aktiviteti: Diskutim në klasë me “peer feedback” nga grupe të tjera. Ushtrime (e enjte): Prezantime paraprake nga grupet + feedback peer review

Java pesëmbëdhjetë:	Testi 2		Qëllimi: Studentët demonstrojnë kompetencat e fituara gjatë kursit.
	Testimi i njohurive të përgjithshme		Aktiviteti: Test i dytë përmbledhës Ushtrime (e enjte): Vazhdimi i prezantimeve + Detyra 7 (grupore): Raporti dhe prezantimi final i projektit hulumtues

Vlerësimi

Vlerësimi në këtë kurs zbaton qasjen e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në këtë kurs synon jo vetëm të verifikojë aftësitë dhe arritjet e studentit të caktuar por edhe bashkëpunimin e tyre brenda grupit dhe ngritjen e përgjegjësisë për të kontribuar në zhvillimin e kolegëve brenda grupit.

Forma e vlerësimit:

1. Detyrat dhe Prezantimi (7 detyra + prezantimi)40%
2. Reflektimi i studentëve (10 reflektime)10%
3. Testi 120 %
4. Testi 225 %
5. Vijueshmëria5 %

Të gjitha obligimet (reflektimet dhe detyrat) të dërgohen ne google classroom. Dokumentet të ruhen si në shembujt më poshtë:

Reflektimi 1. Filan Fisteku, STEAM

Detyra 1. Grupi I, STEAM

Puna në grupe do të menaxhohet në atë mënyrë që kontributi i secilit anëtarë të grupit do të duhet të dëshmohet me rastin e dorëzimit të detyrës.

Skema e vlerësimit:

Pikët (%)	Nota
94 - 100	10
84 - 93	9
73 - 83	8
61 - 72	7
50 - 60	6

Referenca dhe stili i shkrimit

Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kursit dhe në rast të shfrytëzimit të burimeve të tjera duhet t'i binden rregullave të **APA-s**.

Udhëzuesi për Detyrat Grupore (Hartimi i Projektit Hulumtues)

Detyra 0 (grupore): Jepni një titull të shkurtër dhe kuptimplotë për projekt propozimin tuaj (0 pikë)

Detyra 1 (grupore): Draftimi i idesë së projektit hulumtues (5 pikë)

- Qëllimi: Të identifikohet një fushë hulumtimi dhe të formulohet një problem konkret kërkimor.
- Detyra:
 - Zgjidhni një temë nga fusha e edukimit.
 - Formuloni një titull të qartë dhe kuptimplotë.
 - Përkthyeri shkurtimisht problemin dhe rëndësinë e tij.

- Output: 1–2 faqe (titulli + përshkrimi i problemit).

Detyra 2 (grupore): Hyrja dhe rëndësia e projektit hulumtues (5 pikë)

- Qëllimi: Të vendoset konteksti i studimit dhe të justifikohet nevoja e tij.
- Detyra:
 - Përshkruani kontekstin (ku, kë prek, pse ka rëndësi).
 - Argumentoni pse hulumtimi është i nevojshëm.
 - Vendosni qëllimet dhe objektivat kryesore.
 - Shtoni referenca fillestare.
- Output: 2–3 faqe hyrje e strukturuar.

Detyra 3 (grupore): Shqyrtimi i literaturës (5 pikë)

- Qëllimi: Të kuptohet çfarë është bërë deri tani në lidhje me problemin dhe të identifikohet boshllëku.
- Detyra:
 - Zgjidhni 5–7 burime shkencore.
 - Përmbledhni dhe analizoni kritikizmin (fuqitë/dobësitë).
 - Shkruani justifikimin e projektit hulumtues.
- Output: 3–4 faqe përmbledhje me referenca.

Detyra 4 (grupore): Pyetjet, hipotezat dhe dizajni i studimit (5 pikë)

- Qëllimi: Të përcaktohet dizajni i studimit dhe logjika metodologjike.
- Detyra:
 - Hartoni pyetjet kërkimore dhe/ose hipotezat.
 - Përzgjidhni dizajnin (eksperimental, deskriptiv, studim rasti, etj.).
 - Argumentoni zgjedhjen e dizajnit dhe metodës.
- Output: 2–3 faqe me pyetje, hipoteza dhe dizajnin.

Detyra 5 (grupore): Instrumentet dhe mbledhja e të dhënave (5 pikë)

- Qëllimi: Të hartohen instrumentet dhe të praktikohet mbledhja e të dhënave.
- Detyra:
 - Zhvilloni një instrument sasior (pyetësor/test i shkurtër).
 - Zhvilloni një instrument cilësor (intervistë/vëzhgim).
 - Kryeni një mbledhje të vogël të dhënash (pilotim).
- Output: Instrumentet + të dhënat e mbledhura nga një grup i vogël.

Detyra 6 (grupore): Analiza dhe interpretimi i të dhënave (5 pikë)

- Qëllimi: Të praktikohet analiza sasimore dhe cilësore.
- Detyra:
 - Analizoni të dhënat sasimore me metoda bazike statistikore (Excel/SPSS).
 - Kryeni kodimin dhe tematizimin e të dhënave cilësore.
 - Diskutoni gjetjet dhe nxirrni përfundimet.
- Output: Raport i shkurtër (3–4 faqe) me analiza dhe përfundime.

Detyra 7 (grupore): Raporti dhe prezantimi final i projektit hulumtues (10 pikë)

- Qëllimi: Të integrohet puna në një raport të plotë dhe të prezantohet para të tjerëve.
- Detyra:
 - Përpiloni një raport të plotë të projektit hulumtues (10–15 faqe).
 - Përfshini: hyrjen, literaturën, pyetjet/hipotezat, metodologjinë, rezultatet, diskutimin, kufizimet, etiketat.
 - Përgatisni një prezantim (PowerPoint/poster) dhe mbrojeni projektin në klasë.
- Output: Raporti final + prezantimi oral.

Reflektimet paraprake

Për çdo javë, studentët do të lexojnë literaturën e caktuar dhe do të dorëzojnë një refleksion të shkurtër (200–300 fjalë) përpara ligjëratës së së hënës. Reflektimi duhet të përmbledhë idetë kryesore të leximit, të shprehë mendimin tuaj kritik (çfarë keni kuptuar ose çfarë mbetet e paqartë), si dhe të ngrejë një pyetje që mund të

diskutohet në klasë. Reflektimet kanë për qëllim t'ju motivojnë të lexoni me kujdes dhe të përgatiteni për diskutim aktiv.

Rregullat e kursit

Ky kurs kërkon angazhim të plotë akademik dhe respektim të standardeve të Universitetit. Studentët pritet të demonstrojnë profesionalizëm, ndershmëri akademike dhe respekt ndaj mësimit dhe bashkëstudentëve.

1. Standardet akademike dhe etika

- Studentët duhet të përdorin stil akademik në të gjitha detyrat e shkruara.
- Referencat dhe citimet duhet të jenë sipas stilit APA, edicioni i 7-të (shih Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit).
- Çfarëdo përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në detyra duhet të jetë i arsyetuar, i referencuar dhe i shpjeguar nga studenti.
- Kopjimi, plagjiatura dhe çdo formë mashtrimi në detyra ose provime janë të ndaluara dhe do të sanksionohen sipas rregulloreve të UP-së.

2. Pjesëmarrja dhe angazhimi

- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është obligative sipas dispozitave statutare.
- Çdo student duhet të ndjekë ligjëratat, të lexojë literaturën e kërkuar, të marrë pjesë aktive në diskutime dhe të përgatitet për aktivitetet praktike.
- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime llogaritet si pjesë e vlerësimit përfundimtar.
- Studentët kanë të drejtë të bëjnë pyetje, të marrin pjesë në çdo aktivitet dhe të kontribuojnë në mënyrë të respektueshme në diskutime.

3. Detyrat dhe afatet

- Studentët duhet të përgatisin dhe dorëzojnë të gjitha detyrat në kohën e përcaktuar në syllabus.
- Vonesat në dorëzim ndëshkohen me humbje të pikëve, përveç në raste të justifikuara.
- Vetëm studentët që kanë marrë pjesë rregullisht dhe kanë përmbytur detyrat gjatë semestrit kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar.

4. Provimi përfundimtar

- Sipas Neni 115 i Statutit të UP-së, çdo student ka të drejtë të hyjë në provimin përfundimtar jo më shumë se tri herë.
- Studentët që nuk plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes dhe të detyrave nuk mund të paraqiten në provim.

5. Sjellja në klasë

- Përdorimi i telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera nuk lejohet gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe provimeve.
- Ardhja me vonesë dhe largimi nga ora pa arsye të justifikuara nuk lejohen.
- Studentët pritet të tregojnë respekt ndaj mësimit dhe kolegëve, duke kontribuar në një ambient bashkëpunues dhe profesional.

Ndërlidhja e ligjeratave me ushtrime

Ligjëratat dhe ushtrimet janë të konceptuara si pjesë plotësuese të një procesi të vetëm mësues. Ligjëratat shërbejnë për prezantimin e paradigmave, koncepteve teorike dhe metodologjisë së hulumtimit në edukim. Përmes tyre, studentët fitojnë kuptimin bazë të temave, kornizën konceptuale dhe udhëzimet kryesore për realizimin e një projekti hulumtues.

Ndërkohë, ushtrimet praktike organizohen për të ndërtuar ura lidhëse mes teorisë dhe praktikës. Në secilin sesion,

studentët angazhohen në diskutime, punë në grupe, analiza të literaturës dhe aktivitete konkrete (formulimi i pyetjeve kërkimore, hartimi i instrumenteve, analiza e të dhënave, etj.). Këto aktivitete pasqyrojnë temat e trajtuara në ligjëratë dhe u japin studentëve mundësinë që njohuritë teorike t'i shndërrojnë në aftësi praktike.

Koordinimi midis dy pjesëve sigurohet në tri dimensione:

- Çdo ushtrim lidhet drejtpërdrejt me temën e ligjëratës së javës, duke ofruar hapësirë për zbatimin praktik të saj.
- Ligjëratat prezantojnë koncepte dhe modele kërkimore, ndërsa ushtrimet i shndërrojnë ato në veprim konkret përmes ushtrimeve individuale dhe grupore.
- Reflektimet individuale, detyrat grupore dhe prezantimet janë të ndërlidhura me përmbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve, duke siguruar koherencë në përvetësim dhe matje të rezultateve të të nxënit.

Në këtë mënyrë, ndërlidhja mes ligjëratave dhe ushtrimeve siguron koherencë, progresion logjik dhe zhvillim të kompetencave të plota, duke integruar njohuritë, shkathtësitë dhe vlerat që kursi synon të kultivojë.

Literatura

Literatura e obliguar

Librat:

[1] Mattheus, B. & Ross, L.: *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale e humane, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë, 2010.*

[2] Creswell, J. W.: *Educational research, planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research* (3rd ed.). Upper Saddle Creek, NJ: Pearson Education, 2008.

[3] Kumar, R.: Metodologjia e hulumtimit. Nje udhërrëfyes hap pas hapi per fillestare, (SEGA), 2014

Literatura plotësuese

[4] Kocani, A.: *Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*, Ufo Press, Tiranë, 2008.

[5] Creswell, J. W.: *Mixed methods research*. Thousand Oaks: Sage Publications, 2007.

[6] Creswell, J. W.: *Qualitative inquiry and research design: choosing among five traditions*. Thousand Oaks: Sage Publications, 1998.

[7] Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K.: *Research Methods in Education*. (6th edition). Routledge London, 2007.

[8] Patton, Q. M. : *Qualitative Research & Evaluation Methods*. 3d ed. Sage Publication. Inc, 2002.

Artikujt shkencor: